

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

19.04.2023
Ora 12:22

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të disa subjekteve vetëdeklarues, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaaj,**

Znj. M. Koja

• **Parti Politike:**

• **OJQ:**

OSBE/ODIHR

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, ndjesë për fillimin me vonesë të seancës. Atëhere në rendin e ditës sot kemi shqyrtimin e disa projektvendimeve që lidhen me verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për disa kandidatë për kryetar të bashkive për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, pastaj kemi projektvendime që lidhen me raportimin mbi veprimtarinë e institucioneve publike gjatë kësaj periudhe dhe vlerësimin e denoncimeve të disa organizatave të shoqërisë civile mbi veprimtarinë e këtyre institucioneve publike. Kemi të mbartur nga seanca e shkuar projektvendimin që lidhet me caktimin e partive politike që do të propozojnë antarin e tretë dhe të katërt, të grupeve të numërimit të votave, por këtë çështje do ta shtyjme meqënëse kemi një kërkesë nga përfaqësuesi i Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, i cili për arsye objektive nuk mund të marr pjesë sot në seancë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

dhe këtë seancë ndoshta do ta shtyjmë për ditën e nesërme. Mirë atëhere fillojmë me rradhë sipas rendit të ditës, kemi verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak zotin Hasan Xhevid Bejaj, nga Partia Aleanca Demokratike për Bashkinë Selenicë. Po, relatoi të gjitha dhe vetëm do të citojmë kandidatët, të dhënat dhe mbi ç'bazë...

Z. Y. Merkaj: Hasan Bejaj, kandidatë për anëtar këshillin bashkiak, Bashkia Selenicë, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike, gjithashtu dhe kandidati Ilir Aruçi, kandidatë për anëtar të këshillit bashkiak, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Republikane, për Bashkinë Shijak, kandidati zoti Ilir Mollaj, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Mirditë, propozuar nga subjekti zgjedhor Levizja e Legalitetit, subjekti vetëdeklarues zoti Elis Doçi, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë, subjekti vetëdeklarues Erlin Braçaj kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Gramsh, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia e Reformave Demokratike Shqipëtare, subjekti vetëdeklarues Gazmir Albrahimi, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Divjakë, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë, subjekti vetëdeklarues Ervin Muharremi kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Klos, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Konservatore, subjekti vetëdeklarues Ilir Marku, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, propozuar nga Partia Republikane, Bashkia Lushnjë, subjekti vetëdeklarues Artur Karriqi kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Përrenjas, propozuar nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, subjekti vetëdeklarues Roland Zhezha, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë, Bashkia Fier dhe kandidati Gentian Muça, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Tiranë, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Demokratike, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit. Pas verifikimit të formularit të vetëdeklarimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë kërkesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjëndjes së Burgjeve për gjëndjen gjyqësore të këtyre kandidatëve. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka kthyer përgjigje ku të gjithë kandidatët rezultojnë të padënuar me vendim penal të formës së prerë, në Shqipëri. Nga verifikimi i të dhënave në formularët e vetëdeklarimit konstatohet se të gjithë këta kandidatë kanë deklaruar masa shtrënguese në një shtet të huaj për periudha të ndryshme. Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve të mësipërme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacionit shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritetet e vendeve të huaja. Referuar neni 2, pika 2, të ligjit nr. 138 të vitit 2015, përcaktohet se veprat penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk është kompetent për të kryer verifikime. Në këto kushte referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138, të vitit 2015, është Prokuroria e Përgjithshme institucioni që kryen verifikime të plota të vetëdeklarimeve të bëra. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit kryerjen e verifikimit të thelluar dhe dërgimin e të dhënave Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm për të gjithë këta kandidatë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëhere meqënëse jemi në kushtet ku kërkohet informacion nga organi i prokurorisë, do t'i dërgojmë për hetim të thelluar kandidatët vijues, zoti Hasan Xhevid Bejaj, kandidatë për anëtar këshillin bashkiak, Bashkia Selenicë, propozuar nga Aleanca Demokratike e Shqipërisë, kandidatin për anëtar të këshillit të bashkisë, Shijak, të propozuar nga Partia Republikane, zoti Ilir Riza, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak, të Bashkisë Mirditë, propozuar nga Partia Lëvizja e Legalitetit, zoti Gjergj Mollaj, zotin Elis Simon Doçi, kandidat për

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

anëtar të këshillit bashkiak, propozuar nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, për Bashkinë Shkodër, zoti Erlin Behar Braçja, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, për Bashkinë Gramsh, propozuar nga Partia Reforma Demokratike Shqipëtare, zoti Gazmir Abaz Albrahimi, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, propozuar nga subjekti zgjedhor Bashkë Fitojmë, për Bashkinë e Divjakës, kandidati për anëtar këshilli, të Bashkisë Klos, zoti Ervim Muharrem Muharremi, propozuar nga Partia Konservatore, zoti Ilir Brahim Marku, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, të Bashkisë Lushnjë, propozuar nga Partia Republikane, zoti Artur Shefqet Karriqi, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, propozuar nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, për Bashkinë Përrenjas, zoti Roland Thoma Zhezha, kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, Fier, propozuar nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, zoti Gentian Fiqiri Muçaj kandidat për anëtar të këshillit bashkiak, propozuar nga Partia Demokratike për Bashkinë Tiranë.

Vendimi nr. 375-385

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

19.04.2023
Ora 12:31

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarëve të disa bashkive dhe personave përgjegjës për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj,**
 Znj. M. Koja
- **Parti Politike:**
- **OJQ:** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Këto janë, mirë atëhere kalojmë të shqyrtimi i veprimtarisë së institucioneve publike, raportet dhe denoncimet të ardhura nga organizata e shoqërisë civile.

Znj. M. Koja: Do të sygjeroja që fillimisht të bëjmë një përmbledhje të raportimit për periudhën 7 prill- 13 prill 2023. Në ndërfaqen e raportimeve janë raportuar gjithësej 244 aktivitete nga 55 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto veprimtari të raportuara 11 janë zhvilluar në tejkalim të afatit nga 6 institucione, konkretisht Bashkitë Devoll, Shijak, Sarandë, Belsh, Elbasan, dhe Prefekti i Qarkut Fier. Jemi në vijim të komunikimit me këto institucione për të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

kuptuar arsyet, dhe në përfundim të shqyrtimit do dalim me vendimmarrje. Nërsa tani fillojmë me shqyrtimin e...atëhere shqyrtimi administrativ ndaj kryetarëve të disa bashkive për shkeljet administrative të konstatuara nga denoncuesit. Atëhere, janë administruar disa denoncime nga KRIIK në lidhje me disa kryetarë bashkie, konkretisht Kryetari i Bashkisë Cërrik, Delvinë, Dibër, Fier, Fushë-Arrëz, Gjirokastër, Gramsh, Himarë, Kamëz, Klos, Kurbin, Lezhë, Mat, Memaliaj, Patos, Përmet, Sarandë, Shkodër, Tropojë dhe Tiranë. Në pretendim të denoncuesit qëndron fakti që në rrejtin social të kryetarëve të bashkisë janë bërë postime me përmbajtje politike elektorale, të zhvilluara këto nga kryetarët e bashkive. Ne mendojmë që postimet në llogaritë personale në rrjetin Facebook të kryetarëve të bashkive, nuk përbëjnë një provë të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Kryetari i Bashkisë është një organ me karakter dhe natyrë politike, dhe si i tillë ai poston në faqen e tij në Facebook, në platformat e tij sociale, nisma politike apo të tjera veprimtari. Duke qënë se jemi në kushtet e një vakumi ligjor përsa i përket trajtimit të faqeve personale të kryetarëve të bashkive, atëhere ne menduam që nuk mund të provojmë dot një rast shkeljeje të dispostave të Kodit Zgjedhor. Postimet mund të shërbejnë si indicje për të hetuar dhe kjo është ajo që ne kemi bërë duke u siguruar që këto postime me përmbajtje politike të mos ripostohen nga faqet zyrtare të këtyre institucioneve, kështu që në këto kushte ne propozojmë pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj kryetarëve të bashkive që sipërpërmënda.

Z. I. Celibashi: Tani ato janë aktivitete politike, por të cilat janë pasqyruar në rrjete sociale të individëve, jo në rrjetet e institucioneve të bashkisë apo..

Znj. M. Koja: Jo, në faqën elektronike zyrtare të bashkisë janë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Celibashi: Edhe pse në shumicën e rasteve ata janë të njësuar, por teorikisht ai është rrjeti i tij personal dhe pse atje është identifikuar si Kryetar i Bashkisë. Është llogari personale e gjithsecilit.

Znj. M. Koja: Po.

Z. I. Celibashi: Dhe nuk jemi para rastit ku aktivitetet politike janë pasqyruar në rrjetet e institucioneve.

Znj. M. Koja: Ne i monitorojmë dhe ato, por jo deri në këto momente.

Z. I. Celibashi: Po indicie në lidhje me, se vërtetë mund të jetë pasqyruar dhe postuar në rrjetin personal, në llogaritë personale të rrjeteve sociale, një aktivitet politik, por ndoshta dhe një aktivitet institucional, se ne kemi pranuar që edhe aktiviteti institucional nëse pasqyrohet në rrjetin personal, nuk jemi para shkeljes së ligjit për aq sa ligji e rregullon këtë, por ngelet për tu verifikuar dhe nuk e di nëse e keni verifikuar, nëde në këto aktivitete për postimin e këtij aktiviteti ai ka përdorur stafin e, nuk e dimë këtë.

Znj. M. Koja: Këtë nuk e dimë, ato janë takime me banorë, janë takime me përfaqësues politik, janë takime, postime më falni, me tema që trajtojnë promovimin e forcës politike, por nuk e vërtetojmë dot nëse pjesëmarrës janë punonjës të institucioneve apo janë zyrtarë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Celibashi: Për përmbajtjen, për kontentin e materialit që postohet, të themi në rrjetin personal të Facebook-ut të një Kryetari Bashkie dhe pse është personal.

Znj. M. Koja: Përmbajtja është takim me elektoratin, por

Z. I. Celibashi: Por është përgatitur me resurset e bashkisë? Me stafin apo jo? Nuk e kemi këtë informacion?

Znj. M. Koja: Nuk e provojmë dot.

Z. I. Celibashi: Se nëse do ishte kështu atëhere do të kishim të bënim me

Znj. M. Koja: me veprimtari të ndaluara në kuadër të keqpërdorimit të burimeve.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord, ne këtë qëndrim kemi mbajtur , këtë qëndrim do vazhdojmë të mbajmë që në vetvete pasqyrimi në rrjete personale i aktiviteteve si politike por edhe i aktiviteteve institucionale, nuk përbën, nuk është e ndaluar.

Znj. M. Koja: Ne po tregojmë kujdes të shtuar në raport dhe me faqet zyrtare, dhe me ripostimet që bëhen në faqet zyrtare të veprimtarive të kryetarëve të bashkive apo të institucioneve qendrore të tjera.

Z. I. Celibashi: Dakord, vazhdo me të tjerat.

Znj. M. Koja: Ndërkohë kemi në rendin e ditës, janë sërish disa denoncime të bëra nga KRIIK, përse i përket disa veprimtarive të cilat nuk rezultojnë të raportuara në

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkitë, konkretisht është veprimtari e Bashkisë Lushnjë, nga sa konkludohet ngjarja rezulton e raportuar, pra nuk qëndron pretendimi i KRIIK. Nërkohe është një denoncim dhe në Bashkinë Berat, për dy veprimtari të paraportuara, dhe KRIIK i ka marr indiciet nga postimet në rrjetet sociale. Ne kemi hetuar mbi këto indicie të marra, është një takim i Kryetarit të bashkisë Berat me drejtues të institucioneve arsimore, dhe rezulton i raportuar në datën 24 mars, është dhe një takim i dytë i denoncuar nga KRIIK. Nga sa jepet pretendim nga bashkia është një takim i rastësishëm që ka ndoshur me disa zonja gjatë ecjes në rrugë të Kryetarit të Bashkisë, pra nuk ka qënë diçka e planifikuar. Pra ai e ka pasqyruar në rrjetin e tij social këtë fakt që i ka ndodhur. Për Bashkinë Gjirokastrë është gjithashtu një denoncim tjetër për veprimtari të paraportuar dhe rezulton nga ana jonë që veprimtaria është e raportur. Nuk ka qënë e organizuar nga Bashkia Gjirokastrë por nga nje institucion tjetër dhe nuk ka patur detyrim Bashkia Gjirokastrë për ta raportuar. Për Bashkinë Vorë janë tre veprimtari të paraportuara, sipas pretendimeve të bashkisë, këto janë aktivitete të cilat nuk kanë detyrim për raportim sepse janë në përmbushje të detyrave funksionale dhe nuk kanë qënë të hapura me publikun. Për Bashkinë Dibër ka denoncim për veprimtari të paraportuara, dhe për Bashkinë Dibër ne mendojmë që nuk ka qënë një veprimtari me detyrim për raportim, është një takim ndërinstitutional i Kryetarit të Bashkisë me zv/ministrin. Ndërkohe është Bashkia Cërrik për tre veprimtari, pasi u shqyrtuan materialet u vlerësua se natyra e këtyre veprimtarive janë të një karakteri politik dhe jo publik, dhe kështu që nuk mbartin detyrim për tu raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Është një veprimtari e denoncuar për Bashkinë Maliq, dhe nga sa pretendohet nga të denoncuarit ka qënë takim i rastësishëm dhe ky në një lokal fshati, është pasqyruar në rrjetin social por nuk mbart detyrim për raportim, pra nuk jemi para një veprimtarie me karakter publik. Për Bashkinë Finiq qëndron i njëjti

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

arsyetim, nuk është veprimtari publike nga natyra e tij. Për Bashkinë Pogradec rezulton e raportuar veprimtaria, është takimi i Kryetarit të Bashkisë me banorët e lagjes, banorët e një lagjeje në Pogradec, për të diskutuar mbi misionin e kryetarit të bashkisë dhe bashkisë për qëllimin e zonave historike të qytetit, në datën 23 mars rezulton e raportuar. Për bashkinë Kuçovë janë dy veprimtari, këto veprimtari në vlerësimin tonë janë organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrim për raportim në KQZ, pra takimi i Kryetarit të Bashkisë me veteran të zonës ka qënë i ftuar Kryetari i Bashkisë për veprimtari të caktuara të veteranëve të themi, për përkujtimoret që ata kanë. Bashkia Kamëz, ka një veprimtari, inspektim punimesh, ristruksioni i shkollës 9 vjeçare “Fatos Lami” në Zallmner i Ri, raportimi është bërë dhe rezulton i raportuar në KQZ po në datën 23 mars. Bashkia Himarë, ka një tjetër denoncim për këtë bashki për një veprimtari të paraportuar, edhe këtu Kryetari i Bashkisë ka qënë i ftuar në një aktivitet dhe nuk ka detyrim për të raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për nga natyra që ka veprimtaria. Bashkia Divjakë, inspektim punimesh nuk ka qënë me pjesëmarrjen e qytetarëve, e publikut, është një veprimtari brënda funksioneve që ushtron Kryetari i Bashkisë, nga sa argumenton bashkia ne mendojmë që është një veprimtari që bën detyrat funksionale të Kryetarit të Bashkisë. Bashia Pukë për dy veprimtari, është takim me Kryetarin e Bashkisë në njësinë administrative në skuadrën Qelës, kryebashkiaku Gjinaj, pra janë postimet në Facebook, takohet me zv/kryetarin, drejtorin juridik, etj kanë dorëzuar një mjet të ri të emergjencës shefit zjarrëfikës, këto janë veprimtari të cilat kanë ardhur, të themi janë zhvilluar dhe nuk kanë patur mundësi të parashikohen, me çfarë pretendojnë dhe raportojnë bashkia, përfaqësuesit e bashkisë. Përsa i përket veprimtarisë së parë ne mendojmë që është një veprimtari që lidhet me detyrat funksionale të Kryetarit të Bashkisë, ndërsa veprimtaria e dytë nuk përbën veprimtari të ndaluar dhe ne mirëkuptojmë dhe situatën, ka ardhur një mjet i ri e kanë dhuruar,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

e kanë dorëzuar te shërbimi zjarrfikës, nuk mendojmë që duhet të raportohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Përsa referova më lart ne mendojmë që të pushojmë shqyrtimin administrativ dhe mos konstatojmë shkelje për këto raste denoncimesh ndaj institucioneve të lartpërmendura.

Vendimet nr. 386-391

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Celibashi: Një pyetje kam, veç pretendimit në lidhje me raportimin ose mosraportim. të cilat do të duhet t'i koordinojmë edhe me KRIIK se shoh që ka diçka, se ato afatet.. sistemi i tregon nëse është raportuar brenda afatit dhe ...

Znj. M. Koja: Po

Z. I. Celibashi: Dhe ata nga sistemi i kanë marrë besoj. I sqarojmë më vonë me një takim me KRIIK.

Znj. M. Koja: Dakord!

Z. I. Celibashi: Pretendimet në lidhje me keqpërdorim të fondeve për këto aktivitete nuk kemi?

Znj. M. Koja: Jo, janë thjesht për raportim apo për mosraportim. Kryesisht janë objekt mosraportimi në KQZ. Ne kemi bërë vlerësimin tonë për rastet nëse përbëjnë apo jo veprimtari..

Z. I. Celibashi: Që duhet të raportoheshin apo jo?

Znj. M. Koja: Janë një pjesë e tyre që nuk përbëjnë rast. Viojmë me shqyrtimin administrativ të denoncimit nga Qëndresa Qytetare.

Z. I. Celibashi: Me këto institucionet ne kemi pasur komunikim?

Znj. M. Koja: Me të gjitha institucionet.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Celibashi: Dhe kemi marrë përgjigje pak a shumë?

Znj. M. Koja: Po, po.

Z. I. Celibashi: Dakord, vazhdojmë!

Znj. M. Koja: Qëndresa Qytetare, ka bërë një denoncim në KQZ në lidhje me një takim të Kryetarit të Bashkisë Konispol, të deputetes Anila Denaj, të zhvilluar në fshatin Shalës në Konispol. Veprimtaria është zhvilluar në datën 9 shkurt 2023. Ne kemi bërë hetimin e plotë administrativ Qëndresa është dëgjuar dhe në seancën e kaluar. E kemi shtyrë një herë me kërkesë të Qëndresës, sot jemi në momentin e shpalljes së vendimit. Nga sa prova që kemi administruar dhe argumentet e paraqitura nga Bashkia Konispol, Zyra Vendore Arsimore, shkolla 9-vjeçare Shalës, veprimtaria nuk ka qenë veprimtari në axhendën e kryetarit të bashkisë, por është nisur nga kërkesa e kryeplakut të fshatit, të cilët kanë pasur disa problematika që lidheshin me shqetësime të atij komunitetit. Në datën 7 shkurt i është adresuar një kërkesë kryetarit të bashkisë dhe zonjës Denaj. Ata kërkonin një sqarim nga ana e këtyre dy autoriteteve në lidhje me shqetësimet e tyre. Veprimtaria është organizuar në mënyrë të menjëhershme për t'iu përgjigjur nevojës, mesa argumentohet nga Bashkia Konispol. Takimi është zhvilluar në orën 14:00, pra në përfundim të orarit zyrtar, të mësimit në shkollë. Argumentohet që shkolla e këtij fshati është edhe një qendër multifunksionale dhe atë e përdorin sot për çfarëdo lloj takimi dhe aktiviteti dhe nuk është se ka një institucion tjetër publik, ku mund të zhvillohen takime të banorëve me përfaqësues të institucioneve. Ne kemi mbërritur dhe kemi kuptuar që në këtë takim nuk është se ka pasur thirrje për të votuar në një mënyrë të caktuar apo një tjetër. Është bashkëbiseduar me fshatarët për shqetësimet që ata kanë, me banorët

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

e kësaj njësie në lidhje me shqetësimet komunitare që kanë të bëjnë me rrugët, me lejet e tokës, pronësinë e tokës, të gjithë problematikat që ata kanë. Ne mendojmë që nuk është se ka pasur mungesë vullneti për të shmangur nga ana e Kryetarit të Bashkisë Konispol detyrimin për të raportuar në KQZ, këtë veprimtari. Ka qenë një përgjigje e menjëhershme, nga sa provohet nga dokumentet e administruara, në datën 7 shkurt daton shkresa e kryeplakut të fshatit dhe në datën 9 shkurt është zhvilluar veprimtaria në Shalës të Konispolit si njësi administrative. Në këto kushte nuk mendojmë që jemi përpara një shkelje nga ana e kryetarit të bashkisë dhe propozojmë që të pushohet hetimi administrativ për Kryetarin e Bashkisë Konispol.

Z. I. Celibashi: Pretendimi i Qëndresës ka të bëjë thjesht dhe vetëm me raportim, mosraportim të aktivitetit apo edhe keqpërdorim të burimeve?

Znj. M. Koja: Ka të bëjë me mosraportim dhe keqpërdorim të burimeve. Nga sa konstatohet...

Z. I. Celibashi: Mosraportim, e bazon në faktin që është zhvilluar veprimtaria pa u raportuar dhe e kanë konsideruar sipas Qëndresës, veprimtari politike të zhvilluar në një ambient publik.

Znj. M. Koja: Nuk rezulton veprimtari politike.

Z. I. Celibashi: Jo, kështu pretendon Qëndresa.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Znj. M. Koja: Ata mendojnë se takimi i kryetarit dhe i një deputeti siç është shkolla e fshatit Shalës, në Konispol, përbën keqpërdorim, pra i është vënë në dispozicion kryetarit të bashkisë. Pra kryetari i bashkisë ka përdorur shkollën, ka takuar banorët.

Z. I. Celibashi: Ai ka qenë në cilësinë e kryetarit të bashkisë atje dhe jo në cilësinë e.. Është kandidat zotëria?

Znj. M. Koja: Jo

Z. I. Celibashi: Nuk është kandidat për bashkinë ose anëtar këshilli

Znj. M. Koja: Jo, nuk është.

Z. I. Celibashi: Pra ata pretendojnë, bashkia, që “Ne kemi zhvilluar një aktivitet institucional nuk e kemi raportuar sepse nuk ka qene aktiviteti ynë, jemi ftuar nga banorët e fshatit”, ky është shpjegimi i tyre.

Znj. M. Koja: Ky është shpjegimi i tyre dhe i përgjigjet sa më parë të jetë e mundur nevojave.

Z. I. Celibashi: Kemi ndonjë provë që provon të kundërtën. Thirrje politike, votoni këtë, votoni atë?

Znj. M. Koja: Gjithçka që ne administrojmë janë postime të bëra në rrjetin social Facebook.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Celibashi: Nga të cilat rezulton që...

Znj. M. Koja: Rezulton që është bërë takim me banorët e fshatit për problematikat.

Z. I. Celibashi: Vetëm kaq.

Znj. M. Koja: Kaq.

Z. I. Celibashi: Kaq, nuk ka logo të partive politike, thirrje?

Znj. M. Koja: Jo, nuk ka! Thirrje Për të votuar në një mënyrë apo një tjetër, jo nuk ka. Të paktën nga sa dokumentohet.

Z. I. Celibashi: Pra jemi para rastit kur është një aktivitet institucional i kryetarit të bashkisë i zhvilluar në një institucion...

Znj. M. Koja: Dhe në kushte të veçanta të themi. Në kushte të tjera pra, nëse organizohet nga kryetari i bashkisë, do të duhej raportuar, do të ishte sanksionuar. Nuk është nisur nga ai, nuk ishte në agjendën e kryetarit të bashkisë, është nisur në kushtet e një përgjigjeje emergjente, nga sa argumentohet dhe krijon bindjen për ne që jemi para kësaj situatë.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! Nuk jemi para rastit për të vendosur sanksione për titullarin e institucionit në këtë rast. Po, vazhdojmë me poshtë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Znj. M. Koja: Atëherë, në pikën 15 të rendit të ditës, kemi sërish denoncime, por këtë herë nuk janë nga KRIIK të gjitha. Është dega e Partisë Demokratike, Elbasan, ndaj kryetarit të bashkisë Elbasan për disa veprimtari publike të postuara në rrjetin social të kryetarit të bashkisë. Janë veprimtari pak të hershme në fakt, dhe për shkak të kohës që mori dhe bashkërendimi, komunikimi, dhe hetimi me palët ne do të dalim me vendim sot. Janë veprimtari të datës 14 janar, 22 shkurt. Nga sa konstatohet në datën 14 janar është ditë e shtunë. Kryetari i Bashkisë Elbasan së bashku me përfaqësues të tjerë politikë, funksionarë të partisë politike Elbasan ka bërë takime me pensionistë. Nga sa pretendohet nga kryetari i bashkisë nuk është raportuar në KQZ, sepse kjo është një veprimtari, jo në përmbushje të detyrave funksionale, jo në përmbushje të funksionit publik, por është një veprimtari pa asnjë karakter politik dhe si e tillë nuk mbart detyrimin për t'u raportuar në KQZ, dhe kjo krijon bindjen tonë nga sa është deklaruar dhe postuar në rrjetin social, facebook që nuk është veprimtari me karakter publik për t'u raportuar në faqen e KQZ-së.

Z. I. Celibashi: Këto janë në rrjetin personal apo në rrjetin e bashkisë?

Znj. M. Koja: Jo, jo në rrjetin personal. Ankesa është marrë vetëm nga postimet në rrjetin personal të kryetarit të bashkisë. Ndërkohë Partia Demokratike raporton edhe një veprimtari, denoncon edhe një herë kryetarin e bashkisë për një veprimtari të tij në bashki, dhe pretendon se është e paraportuar, me keqpërdorim të burimeve. Ne konfirmojmë që veprimtaria është raportuar në datën 22 shkurt, në faqen e KQZ-së, dhe nga sa është vlerësuar dhe në periudhën e monitorimit që i përket kjo datë, ajo është një veprimtari publike dhe nuk ka qenë në kushtet e ndalimit nga KQZ-ja. Ndërkohë kemi një pretendim se një veprimtari e Bashkisë Korçë, ku kemi përdorim

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

të burimeve publike, nga raporti i monitorimit të një monitoruesi të KQZ-së në terren. Është një veprimtari e zhvilluar nga kryetari i bashkisë në fakt në...

Z. I. Celibashi: Tani për këtë më duket se kemi dhe një denoncim nga Qëndresa Qytetare.

Znj. M. Koja: Është një rast tjetër ai.

Z. I. Celibashi: Ah nuk është ky rast!

Znj. M. Koja: Nuk është ky rast. Nuk është kjo. Jo nuk është kjo. Kjo është sjellë në vëmendje nga monitoruesit e KQZ-së në Bashkinë Korçë. Në fakt, atje është një aktivitet i sponsorizuar nga një OJF, ku ndahen ndihma ushqimore me logon e bashkisë. Është një veprimtari e raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, sqarohet se fondet vijnë nga një fondacion "Care for Albania".

Z. I. Celibashi: Kush e ka sjellë në vëmendje. Monitorues i joni, mirë, shumë mirë.

Znj. M. Koja: Po, i joni e ka sjellë në vëmendje. Ne mendojmë që është një veprimtari e raportuar, është në përmbushje të funksioneve, detyrave që bashkia ka. Nuk kemi fare një shkelje

Z. I. Celibashi: Kemi marrë informacion nga bashkia.

Znj. M. Koja: Pretendime, po, po, kështu që hetimi është bërë i plotë. Gjithashtu është dhe një denoncim nga KRIIK për bashkinë Rrogozhinë. Për një postim, për një

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

veprimtari me mesazhe elektorale. Inspektimi i punës për sistemimin e kanaleve Peqin- Kavajë, në njësinë administrative Gosë, bashkia Rrogozhinë. Veprimtaria është kryer nga kryetari i bashkisë dhe deputet, një deputet, pjesëmarrës, që e kanë postuar dhe në faqet e tyre përkatëse pra, kryetari dhe deputeti. Kjo veprimtari është e raportuar në faqen zyrtare të KQZ-së , në datën 1 mars dhe në momentin që është vlerësuar dhe tani që po e vlerësojmë nuk përbën veprimtari të ndaluar. Pra, kemi mbajtur qëndrimin që pjesëmarrja e deputeteve për sa kohë nuk bëhet thirrje për të votuar në një mënyre të caktuar, atëherë nuk ka ndonjë ndalim për këtë... legjislacioni. KRIIK ka denoncuar sërish Bashkinë Fier, për një veprimtari me mesazhe elektorale. Është një veprimtari e zhvilluar në dt. 18 shkurt, e raportuar në dt. 18 shkurt, në faqen e KQZ-së. Është një veprimtari publike, vizitë në një kompleks të përpunimit të mishit në Fier. Nga sa konkludohet, kjo veprimtari dhe pjesëmarrja e kryetarit të bashkisë është në përmbushje të detyrave të tij, si funksionar publik dhe në këto kushte mendojmë që nuk jemi përpara një shkeljeje. Bashkia Belsh, pretendohet nga KRIIK se është një veprimtari publike me mesazhe elektorale. Kryetari i bashkisë Belsh Arif Tafani, drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun e Elbasanit, thotë denoncuesi: “Kanë marrë pjesë së bashku në një inspektim”. Kjo është veprimtari e raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Veprimtaria e kryer nuk përbën veprimtari të ndaluar, pasi...

Z. I. Celibashi: Ka pasur përfaqësues politikë në këtë veprimtari?

Znj. M. Koja: Ka pasur përfaqësues deputet, por nuk janë përdorur logo, nuk ka pasur fletë me përmbajtje elektorale nga sa verifikohet nga videot e publikuara në faqe në rrjetin social facebook, nuk ka pasur...

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Celibashi: Kërkoj më shumë sqarime për këtë.

Znj. M. Koja: Dakord! Është rasti i Bashkisë Lushnje, një veprimtari publike me mesazhe elektorale dhe kjo, me pjesëmarrjen të një deputeti. Është një veprimtari e raportuar në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 28 shkurt. Nga sa konstatohet nga publikimet në faqen sociale...

Z. I. Celibashi: Edhe për këtë do të kërkoj më shumë sqarim.

Znj. M. Koja: Dakord! Dhe me këtë raportim përfundon dhe vendimmarrja për këto raste denoncimesh, pra me 2 raste të shtyra dhe për rastet e tjera ne propozojmë pushimin dhe moskonstastimin e shkeljes, përjashtimisht ato që ju kërkuat të shtyhen; Bashkinë Belsh dhe Bashkinë Lushnje.

Z. I. Celibashi: Kemi dhe një rast tjetër për bashkinë Lushnje, për mosraportimin për një aktivitet të ndaluar.

Znj. M. Koja: Atëherë, një veprimtari e raportuar në datën 25 mars për t'u zhvilluar në datën 30 mars, nga Bashkia Lushnjë, inspektim punimesh palestra e shkollës "Foto Puka" me pjesëmarrës kryetarin e bashkisë dhe përfaqësuesin politik, citohet në raportim. Në datën 28 mars, Komisioneri ka marrë vendim për ndalimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie, nisur nga pjesëmarrja e personave politike në të. Në datën 29 është njoftuar për vendimin e Komisionerit për ndalimin e veprimtarisë. Rezulton që veprimtaria është zhvilluar. U janw kërkuar shpjegime dhe u verifikua se kryetari i bashkisë ka marrë dijeni për ndalimin e veprimtarisë nga ana e KQZ-së,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

dhe për pasojë ne sugjerojmë t'i propozojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve, sanksion administrativ për Kryetarin e Bashkisë Lushnje.

Z. I. Celibashi: Domethënë veprimtaria që ne kemi vendosur për të mos u zhvilluar, është zhvilluar.

Znj. M. Koja: Personi përgjegjës për raportimin ka marrë dijeni, ka njoftuar kryetarin e bashkisë dhe në çdo rast veprimtaria është zhvilluar, pavarësisht njoftimit dhe marrjes së tij.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë do të vendosim për të pasur sanksione dhe t'i propozojmë KAS-it që vendosjen e sanksioneve për Kryetarin e Bashkisë Lushnje, për këtë aktivitet dhe personit përgjegjës gjithashtu, për raportimet.

Znj. M. Koja: Dakord! Ndërkohë një situatë të ngjashme është me Bashkinë Korçë.

Z. I. Celibashi: Po ky është ai rasti që ka sjellë dhe Qëndresa.

Znj. M. Koja: Po

Z. I. Celibashi: Ta marrësh në shqyrtim bashkë me atë të Qëndresës edhe kur të jemi në një seance tjetër, ku të jenë edhe përfaqësues të Qëndresës për ta paraqitur, nëse dëshirojnë ata vetë ta paraqesin si denoncim. Dakord!

Znj. M. Koja: Kemi edhe një vendimmarrje tjetër në lidhje me 3 denoncime të KRIIK për veprimtari të paraportuara. Janë veprimtaria e Bashkisë Tropojë, me

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

rastin e 100-vjetorit të shkollës “Jaho Salihu” në Bujan, të Krasniqit të Malësisë e Madhe. Është një veprimtari në fakt, me sa na rezulton me pjesëmarrje të mësuesve të shkollës të fëmijëve. Mendojmë që është një veprimtari me karakter publik, që duhej të ishte raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, propozojmë që t’i propozohet Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, sanksion për kryetarin e bashkisë dhe personit përgjegjës për raportimin të Bashkisë Tropojë.

Z. I. Celibashi: Po për personin përgjegjës për raportimin, sepse është përgjegjësia e tij direkte t’i propozojmë vendosjen e një sanksioni për këtë rast edhe pse natyra e aktivitetit në fakt, është e tillë që nuk ka lidhje me keqpërdorim të fondeve pasi... . Gjithsesi do të duhej ta kishte raportuar.

Znj. M. Koja: Ndërkohë janë dy veprimtari të bashkive Devoll dhe Fushë –Arrëz. Në rastin e parë është në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas. Është një veprimtari në fakt, e përbashkët ndërmjet Bashkisë Devoll, UNDP-së, qendra “T’reja”, me gra të komunitetit rom, kundra diskriminimit, dhunës apo të trajtimit të pabarabartë mes vajzave dhe grave. Ne nuk mendojmë që jemi përpara një rasti të një shkeljeje dhe të sanksionojmë rastin konkret. Gjithashtu në kuadër të 8 Marsit është dhe një takim i Kryetarit të Bashkisë Fushë –Arrëz, me gra dhe vajza. Edhe në këtë rast mendojmë që është një veprimtari e organizuar me rastin e festës së 8 Marsit, dhe nuk ka qenë në axhendë dhe nuk është në axhendë të kryetarit të bashkisë.

Z. I. Celibashi: Ka qene i ftuar atje.

Znj. M. Koja: Po, ka qenë i ftuar në atë aktivitet, ku janë përfaqësues të OJF-ve, gra të ndryshme të komunitetit.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Celibashi: Po, Çështje te tjera?

Znj. M. Koja: Jo.

Z. I. Celibashi: Jo, nuk kemi. Seanca mbyllet dhe për seancën e nesërme do të njoftojmë çfarë ore.

Vendimet nr. 386-391

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

